

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: Operatori ekonomik “BEQIRI” shpk

Adresa: Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte.

1.Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”.

Objekti: “Ndertim Ura e Bonorakeve, Ibe e Poshtme”

2.Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Ndërtim Ura e Bonorakeve, Ibë e Poshtme”

3.Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-08198-06-05-2024

4.Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

5.Fondi limit: 79,515,159.68 (shtatëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

6.Burimi i financimit: *Të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2024* miratuar me VKB Nr.36, date 28.03.2024 ”per disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin Nr.125, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2024”.

7.Kohëzgjatja e kontratës: 6 (gjashtë) muaj.

8.Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21 / 06 /2024 Ora 10: 00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.30 datë 10.06.2024.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk

NIPT K51501008J

Vlera e ofertës: **61,111,111.00** (gjashtëdhjetë e një milion e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i operatoreve ekonomike GLAVENICA shpk & NGRACAN 1934 shpk

NIPT K17710805A & J87602809S

Vlera e ofertës: **68,573,946.00** (gjashtëdhjetë e tetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “SENKA” shpk

NIPT J94808405Q

Vlera e ofertës: **71,563,582.34** (shtatëdhjetë e një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy pikë tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “BEQIRI” shpk

NIPT J98624801V

Vlera e ofertës: **74,581,447.50** (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “INA” shpk

NIPT J61814009W

Vlera e ofertës: **78,048,245.75** (shtatëdhjetë e tetë milion e dyzet e tetë mijë e dyqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “SENKA” shpk

Nga kontrolli aritmetik i ofertes ekonomike te paraqitur nga operatori ekonomik SENKA shpk, rezultoi se oferta e paraqitur eshte me gabim mbi 2 %.

2. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C ”*Deklaratë Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobetoniere me targa AA 582UZ, sipas Kontrates se Qerase Nr.6886 Rep e Nr.3332 Kol., date 02.05.2024 (me afat 5 vjar). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per mjetin Autobetoniere me targa AA 582UZ, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C ”*Deklaratë për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ka deklaruar se disponon 1 (një) Sonde shpimi per pilota, sipas Kontrates se Qerase Nr.134 Rep e Nr.89 Kol., date 06.01.2023 (me afat 5 vjar). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per 1 (nje) Sonde shpimi per pilota, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria C ”*Deklaratë Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ka deklaruar se disponon 1 (një) Autovinc 100 Ton me targa AA 582 JN, sipas Kontrates se Qerase date 19.06.2024 (me afat deri ne perfundim te punimeve). Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon dokumentacioni per mjetin Autovinc 100 Ton me targa AA 582 JN, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 11.

Operatori ekonomik “S I R E T A 2F” shpk në Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit, Pjesa III, Kategoria B ”*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate*”, ka deklaruar punonjesin me profesion Buldozerist z.Thanas Bico. Pas verifikimit te dokumentacionit te dorezuar, u konstatua se mungon kontrata e punes per punonjesin Buldozerist, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 8.

3. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk

Operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk nuk permbush Kriteret e Pergjithshme te Kualifikimit, pika 3, ku percaktohet se: “*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...*”. Nga verifikimi dokumentacionit te paraqitur ne sistemin elektronik te prokurimit rezultoi se operatori ekonomik “GLAVENICA” shpk per permbushjen e kriterit te mesiperem, ka deklaruar punonjesin me iniciale V.N i cili nga deklarimi perkates rezulton Ing. Topograf, cka bie ne kundërshtim me udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: “*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë,*

përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “BEQIRI” shpk, Adresa: Fier, Lagjja 15 Tetori, rruga Todi Shkurta, pallati 10 katësh me nr-47/2, kati i dyte** se oferta e paraqitur me vlerë totale **74,581,447.50** (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzet e shtatë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në Nenin 109 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).